



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:097180

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05546831

**P.nr.307/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal,** gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit V.K nga Peja, për shkak dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer vepër penale „Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr.339/2023 të datës 25.04.2023, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestarë me datë 03.03.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit V. K, me datë 04.03.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 03.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

**V.K,** i biri i Sh dhe i nënës H i vajzërisë M , i lindur me datë ..... në fsh.Ll K. Pejë, me vendbanim në Pejë Rr., B.K’’ nr..., ka të kryer shkollën ....., i ....., punëtor i....., i gjendjes së dobët ekonomike, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal ..... posedon tel:....., shqiptarë, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, gjendet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse** Me datë .....2023, rreth orës ....., Rr., B.K ‘’ në Pejë, pikërisht në shtëpinë e tij brenda marrëdhënies familjare, në gjendje të dehur me dashje, përdor forcën ndaj të dëmtuarit B.K të cilin e ka ....., në atë mënyrë që natën kritike, deri sa i dëmtuari ishte duke qëndruar në shtëpi aty vjen i pandehuri, i cili ia kërkon telefonin të dëmtuarit, e kur i dëmtuari nuk ia jep telefonin atëherë i pandehuri acarohet dhe ia hedh telefonin nga dora duke ia gjuajtur në dysHEME e pastaj e godet të njëjtin me shuplake në fytyrë,

- me çka ka kryer vepër penale „ Sulmi’’ nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 39, 40, 42, 45, 69, 70, të KPRK-së, neni 184 par.2 të KPRK-së, nenit 364, 449 par.1 dhe 2, nen par.2.6, 462 par.2 të KPPK-së, të pandehurit **V. K** i shqipton:

**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë ) ditësh**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me:

### **URDHËR PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITSHME**

- I.** në kohëzgjatje prej **160 (njëqind e gjashtëdhjetë) orëve** e cila punë duhet të kryhet në afat prej **1 (një) viti** në përputhje me nenin 45 par. 3 të KPRK-së nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Vendin e kryerjes së punës (punë në dobi të përgjithshme), orarin e punës llojin e punës që duhet ta kryej i dënuari do ta caktoj Shërbimi Sprovues i Kosovës, konform nenit 45 par. 2 të KPK-së.
- III.** Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.
- IV.** I pandehuri obligohet gjykatës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.**
- V.** I pandehuri obligohet ta paguaj taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.**
- VI.** Pala e dëmtuar B. K nga Peja rr., B.K'' për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.339/2023 me datë 25.04.2023 , kundër të pandehurit V.K nga Peja, për shkak të veprës penale, ,, Sulm'' nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 03.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha të pandehurit V.K, ndërsa mungonte i dëmtuari B.K i cili sipas të pandehurit gjendet jashtë shtetit konkretisht në Gj.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II.nr.339/2023 të datës 25.04.2023, në seancën e shqyrtimit fillestarë, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

I pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa presion, pendohet për veprimet që i ka bërë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se meqenëse pranimi i fajësisë mbështetet në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit policor Kushtrim Gashi i përpiluar me datë 10.02.2023,deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me datë 10.03.2023,deklarata e dëshmitarit e dhënë në polici me datë 10.02.2023,raporti mjekësor me nr protokolli 601 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë me datë 10.02.2023,deklarata e dëshmitarit L.K e dhënë në polici me datë 10.02.2023,deklarata e të dyshuarit e dhënë në polici me datë 11.02.2023,akt ekspertimi mjeko –ligjor i punuar nga eksperti mjeko-ligjor Naim Uka i dt.30.03.2023 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës, që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese i propozoj ta merr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies si dhe dënimet e mëparshme të të pandehurit.

I pandehuri i propozoi gjykatës që për të të merret si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë, përmirësimin e raporteve me këtu të dëmtuarin, pendimin e tij pasi theksoj se veprimet e natës kritike i kishte bërë nën ndikim të alkoolit.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, padyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit V.K qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pendimin e thellë të tij, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata

pati parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe atë ndaj ..... të tij.

Vendimin për zëvendësimin e dënimit me burgim në urdhër për punë në dobi të përgjithshme gjykata morri në bazë të nenit 45 të KPPRK-së, ku pëlqimin e të pandehurit e mori pas shpalljes së aktgjykimit dhe përmes parashtrësës të dt. 04.03.2024.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 par. 1 të KPPRK-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**P.nr.307/2023, dt. 03.04.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Gylaj Nepola

**Gjyqtare e vetme gjykuese**  
Ilda Cucović Sahatçiu

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë